



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada – Government
Ministria e Shëndetësisë/Ministarstvo Zdravstva/Ministry Of Health
Komuna Vushtrri
Opština Vuçitern–Municipality of Vushtrri



REPUBLIC OF KOSOVO - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA - GOVERNMENT OF KOSOVA
MINISTRIA E SHËNDETËSISË - MINISTARSTVO ZDRAVLJA - MINISTRY OF HEALTH

Njësia Org. N. Prot.
Org. Jedinica Prot. Prot.
Org. Unit. Proc. No. **05-7032**

Nr. i faqeve Data:
Br. stranica Datum: **01/11/2023**
No. pages Prishtinë / a

02
- 2 -

MARRËVESHJE

REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRISË - OPŠTINA VUÇITRN

02 Nr. / Br. **1271/23**
Nr. i fq. / Br. sf. **-02-**
Data: / Datum **27.10.2023**
VUSHTRRI - VUÇITRN

Neni 1 Palët në marrëveshje

Ministria e Shëndetësisë, përfaqësuar nga Dr. Naim Bardiqi, Sekretar i Përgjithshëm Komuna e Vushtrrisë, përfaqësuar nga Z. Ferit Idrizi, Kryetar i Komunës.

Neni 2 Qëllimi i marrëveshjes

Ministria e Shëndetësisë (Dhuruesi) ja dhuron QKMF-së në Vushtrri (Pranuesi) automjetin e ri me pajisje përcjellëse për nevoja të shëndetësisë së komunës.

Neni 3 Obligimet e Ministrisë së Shëndetësisë

Ministria e Shëndetësisë obligohet që automjetin e ri "PEUGEOT" me numër të shasisë; VR3EFYHT2PJ742389 t'ia dorëzojë komunës së Vushtrrisë me rastin e nënshkrimit të kësaj marrëveshje.

Ministria e Shëndetësisë, obligohet që automjetin e dhuruar ta fshijë nga lista e pasurisë së Ministrisë së Shëndetësisë.

Neni 4 Obligimet e Komunës së Vushtrrisë

Komuna e Vushtrrisë obligohet që automjetin e pranuar nga Ministria e Shëndetësisë duhet ta përdorë vetëm për nevojat dhe aktivitetet e shërbimeve shëndetësore si për vaksinim (Ruajtja dhe mirëmbajtjen e zingjirit të ftohtët të vaksinimit dhe produkteve tjera termolabile), për vizita në shtëpi, Nëna dhe fëmiju, Paliacioni dhe shërbime tjera sipas nevojës.

Komuna e Vushtrrisë duhet të përkujdeset për të gjitha obligimet që rrjedhin lidhur me automjetin si: regjistrimi, servisimi si dhe mirëmbajtja funksionale e automjetit.

Komuna e Vushtrrisë obligohet që automjetin e pranuar nga Ministria e Shëndetësisë ta regjistrojë në listën e pasurisë së komunës.

Neni 5
Afati i dorëzimit

Dorëzimi i automjetit, objekt i kësaj marrëveshje, nga ana e dhuruesit do të bëhet ditën e nesërme pas nënshkrimit të marrëveshjes nga palët.

Neni 6
Kalimi i Pronësisë

Kalimi i pronësisë së automjetit, objekt i kësaj kontrate, do të bëhet menjëherë pas nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje nga të dy palët.

Neni 7
Zbatimi

Me nënshkrim të kësaj marrëveshjeje, palëve u lind detyrimi që ti përmbahen obligimeve të përcaktuara, përndryshe pasojnë dispozitat e ligjit përkatës në fuqi të Republikës së Kosovës.

Neni 8
Hyrja në fuqi

Marrëveshja nënshkruhet në tri kopje origjinale dhe hyn në fuqi në momentin e nënshkrimit nga palët nënshkruese.

Prishtinë
27.10.2023

Ministria e Shëndetësisë


Dr. Naim Bardiq, Sekretar i Përgjithshëm



Komuna e Vushtrrisë


Z. Ferit Idrizi, kryetar

